



This project is funded  
by the European Union



# RREGULLORE PËR PUNË PLATFORMA PËR INVESTIME NË KOMUNITET (CIP)

## СОДРЖИНА

- I. ОПШТИ ОДРЕДБИ И СТАТУС НА ПЛАТФОРМАТА..... **Error! Bookmark not defined.**
- II. ОРГАНИ И ТЕЛА НА ПЛАТФОРМАТА .....**Error! Bookmark not defined.**
- III. ПРАВА И ОБВРСКИ НА ЧЛЕНКИТЕ НА ПЛАТФОРМАТА ...**Error! Bookmark not defined.**
- IV. УСЛОВИ И ПОСТАПКИ ЗА ПРИЕМ НА ЧЛЕНСТВО ..... **Error! Bookmark not defined.**
- V. УСЛОВИ И ПОСТАПКА ЗА ИСКЛУЧУВАЊЕ НА ЧЛЕНКИТЕ ОД ПЛАТФОРМАТА.....**Error! Bookmark not defined.**
- VI. VII ЗАВРШНИ ОДРЕДБИ.....**Error! Bookmark not defined.**

## I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME DHE STATUSI I PLATFORMËS

### Lënda e rregullimit

#### Neni 1

1. Me këtë rregullore caktohen të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të Platformës së OQ për bashkëpunim me sektorin e biznesit “OQ-biznes platforma”, organet dhe fushëveprimi i punës, mënyra e vendimmarrjes, kushtet dhe procedura për anëtarësim, shkaqet dhe procedurat për përjashtim nga anëtarësia, si dhe çështje tjera me rëndësi për punën e platformës.

### Statusi i platformës

#### Neni 2

1. Platforma është formë e shoqërimit vullnetar e organizatave individuale dhe të pavarura, të cilat me punën e deritanishme kanë dëshmuar se e respektojnë dhe i aplikojnë vlerat e platformës.
2. Platforma i përfshinë organizatat të cilat përpiqen të sigurojnë diverzifikim të ardhurave të tyre përmes gjenerimit të ardhurave personale nga aktivitete ekonomike, përmes bashkëpunimit me sektorin afarist dhe qasjen e lehtësuar deri te donatorët dhe fondet ndërkombëtare.
3. Në momentin e themelimit, platforma përfshinë organizata nga regjioni veri-perëndimor, i Shkupit, veri-lindor dhe jug-perëndimor i R. Maqedonisë. Varësisht nga zhvillimi i platformës, lihet mundësia për zgjerim të përfshirjes gjeografike të anëtarësisë.
4. Në momentin e themelimit platforma nuk ka status të personit juridik dhe vepron si platformë joformale. Varësisht nga arritjet prej punës lihet mundësia pas një periudhe të caktuar (jo më të gjatë se 12 muaj nga funksionimi i platformës) platforma të shndërrohet në person juridik në pajtim me Ligjin për shoqata dhe fondacione.

## II. ORGANET DHE TRUPAT E PLATFORMËS

### Organet dhe trupat e platformës

#### Neni 3

1. Organet e platformës janë: Kuvendi, Këshilli drejtues, Sekretariati, Këshilli mbikëqyrës, Kryetari/rja/Kryesuesi/sja.
2. Për nevojat e realizimit të qëllimeve programore dhe aktiviteteve, platforma do të themelojë edhe Komitete sektoriale.
3. Në periudhën e kohëzgjatjes së projektit të financuar nga Bashkimi Evropian, rolin e Sekretariatit do ta ketë Fondacioni Albiz.
4. Çdo anëtar i platformës cakton person për kontakt dhe zëvendës për periudhë prej një viti, në emrin e të cilit do të kontaktojë me platformën.
5. Për realizimin e misionit të vet, platforma lidh Memorandum për bashkëpunim me biznes shoqatat, odat, NJVL dhe organizatat, institucionet, kompanitë dhe mediat tjera.

### Përbërja dhe veprimi i Kuvendit

#### Neni 4

1. Kuvendin e përbëjnë të gjitha organizatat të cilat janë anëtare në platformë. Çdo anëtare është e përfaqësuar me nga 1 (një) përfaqësues.
2. Kuvendi:
  - I miraton dokumentet strategjike, programin për punë, raportet dhe aktet tjera të platformës,
  - E zgjedh Këshillin drejtues, Këshillin mbikëqyrës, Sekretariatit, Kryetarin/en dhe Komitetet sektoriale,
  - Vendos për pranimin dhe përjashtimin e anëtarësisë në platformë dhe
  - Kryen punë tjera të caktuara me aktet e përgjithshme të platformës.

## Mbledhjet e Kuvendit dhe mënyra e vendimmarrjes

### Neni 5

1. Mbledhja e rregullt e Kuvendit mbahet një herë në vjet.
2. Sipas nevojës, mund të thirren edhe mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit.
3. Mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme i cakton Sekretariati i platformës.
4. Nëse nuk ka mjetet të mjaftueshme financiare për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit, të njëjtat mund të realizohen përmes postës elektronike (përmes e-mail listës).
5. Kuvendi vendos në bazë të propozimeve, qëndrimeve, mendimeve, iniciativave, rekomandimeve dhe përfundimeve.
6. Kuvendi vendimet i miraton me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të pranishëm.
7. Për mbajtjen e Kuvendit nevojitet prezenca e minimum 50%+1 nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të platformës të cilët kanë të drejtë vote.
8. Votimi është publik, përveç gjatë zgjedhjes së Këshillit drejtues, Sekretariatit dhe Kryetarit/es ku votohet me votë të fshehtë.

## Përbërja dhe fushëveprimi i Këshillit drejtues

### Neni 6

1. Këshilli drejtues është organ ekzekutiv i platformës që e përbëjnë 9 (nëntë) anëtarë të zgjedhur nga ana e Kuvendit.
2. Anëtarët e Këshillit drejtues janë nga radhët e shoqatave dhe fondacioneve anëtarë të platformës.
3. Kandidatura për anëtarë të Këshillit drejtues është publike, në bazë të nominimit dhe vetë-nominimit.
4. Gjatë zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit drejtues mbahet llogari për përfaqësimin e drejt gjeografik, gjinor dhe sektorial.
5. Anëtarët e Këshillit drejtues zgjidhen me vota të fshehta, me mandat prej 1 (një) viti.
6. Procedurën për zgjedhje të anëtarëve të Këshillit drejtues e zbaton Sekretariati.

## 7. Këshilli drejtues:

- e realizon programin dhe planin vjetor për punë të platformës;
- përgatit propozime për aktet e përgjithshme dhe vendimet i miraton Kuvendi;
- përgatit raportet për punë të platformës;
- i thirre mbledhjet e Kuvendit,
- e nxitë komunikimin mes anëtarëve të programit dhe
- i zhvillon marrëdhëniet me opinionin.

**Mbledhjet e Këshillit drejtues dhe mënyra e vendimmarrjes****Neni 7**

1. Këshilli drejtues mban mbledhje së paku një herë në tre muaj.
2. Nëse nuk ka mbledhje të mjaftueshme financiare për mbajtjen e mbledhjeve, të njëjtat mund të zhvillohen përmes postës elektronike (e-mail lista).
3. Këshilli drejtues vendos në formë të propozimeve, qëndrimeve, mendimeve, iniciativave, rekomandimeve dhe përfundimeve.
4. Këshilli drejtues i miraton vendimet me shumicë prej numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit drejtues.
5. Votimi është publik, përveç nëse Këshilli drejtues nuk vendos të votojë me vota të fshehta.

**Kryetari/rja e platformës****Neni 8**

1. Kryetari/rja e përfaqëson platformën dhe kryeson me mbledhjet e Kuvendit dhe të Këshillit drejtues.
2. Kryetari/rja zgjidhet nga radhët e anëtarëve të platformës, për periudhë prej një viti.
3. Pozita e Kryetarit/res është vullnetare.

**Sekretariati i platformës****Neni 9**

1. Sekretariati e koordinon komunikimin dhe realizimin e programit dhe planit për punë të platformës.
2. Sekretariati shërben si pikë kontakti e platformës.

3. Në periudhën deri në shtator 2017 rolin e Sekretariatit do ta ketë Fondacioni Albiz.
4. Sekretariati zgjidhet nga ana e Kuvendit në bazë të interesimit të shprehur të një ose më shumë anëtarëve të platformës.

### **Këshilli mbikëqyrës**

#### **Neni 10**

1. Këshilli mbikëqyrës e mbikëqyr dhe e ndjek punën e Këshillit mbikëqyrës.
2. Këshilli mbikëqyrës përbëhet prej 3 (tre) anëtarëve, 2 (dy) anëtarëve nga radhët e anëtarëve të platformës dhe 1 (një) anëtar të jashtëm.
3. Këshilli mbikëqyrës zgjidhet me vota publike, me mandat prej 2 (dy) viteve.

### **Komitetet sektoriale**

#### **Neni 11**

1. Komitetet sektoriale paraqesin grupe punuese të platformës dhe formohen për realizimin e detyrave konkrete programore në pajtim me qëllimet strategjike të platformës.
2. Komitetet sektoriale (KS) të platformës janë: KS për avokim dhe lobim, KS për grumbullimin e mjeteve, KS për promovim dhe marketing, KS për përgatitjen e propozim-projekteve
3. Çdo komitet sektorial përbëhet prej 5-7 anëtarë, përfaqësues të anëtarëve të platformës.
4. Anëtarët e grupit punues zgjidhen sipas parimit të vetë-nominimit me interesim të shprehur për anëtarësim në komitet dhe vërtetohet me shumicë të thjeshtë me vota publike.

## **III. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E ANËTARËVE TË PLATFORMËS**

### **Të drejtat dhe obligimet e anëtarëve**

#### **Neni 12**

1. Anëtarët e platformës i kanë këto të drejta dhe obligime:
  - Të marre pjesë në krijimin e politikave të platformës;
  - Të inicioje dhe të japë propozime për aktivitetet e platformës në pajtim me planin strategjik dhe parimet e platformës;
  - Të zgjedhe, të zgjidhet dhe të marre pjesë në punën e organeve dhe trupave të platformës;
  - Ti përfaqësoje në opinion interesat e platformës;

- Të distribuojë informata për punën e vet përmes e-mail listës së platformës;
  - Të pranojë informata dhe raporte për punën e platformës dhe anëtarët e saj;
  - T'i përmbushë në kohë detyrat e ndërmarra dhe të deklarojë sipas propozimeve të organeve dhe trupave të platformës;
  - Rregullisht të marrë pjesë në mbledhjet e Kuvendit;
  - Të dale nga platforma.
2. Anëtarët shoqëruar marrin pjesë në punën e trupave dhe organeve të platformës pa të drejtë vote.

## IV. KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR PRANIM TË ANËTARËSISË

### Kushtet për pranim të anëtarësisë së organizatave

#### Neni 13

1. Platforma është e hapur për të gjitha organizatat të cilat veprojnë me interes publik në regjionet gjeografike në të cilat vepron platforma.
2. Anëtarësimi në platformë mund të jetë i plotfuqishëm ose shoqëruar.

#### Neni 14

1. Për pranim si anëtar i plotfuqishëm i platformës, organizatat e interesuara duhet t'i plotësojnë këto kushte:
  - Të veprojnë si subjekt juridik së paku 3 (tre) vjet;
  - Në mënyrë aktive të veprojnë në fushat me interes publik (përkundër interesit vetëm të anëtarësisë së vet);
  - T'i pranojë vlerat dhe rregullat për punë të platformës;
  - Nëse organizata e interesuar është tashmë rrjet ekzistues, do të trajtohet si organizatë individuale.

#### Neni 15

2. Për pranim si anëtare shoqëruar, organizata e interesuar duhet t'i plotësojë këto kushte:
  - Të veprojnë si subjekt juridik së paku 6 muaj;
  - Të veprojnë në mënyrë aktive në fushat me interes publik (përkundër interesit vetëm të anëtarësisë së saj);
  - T'i pranojë vlerat dhe rregullat për punë të platformës;
  - Nëse organizata e interesuar është tashmë rrjet ekzistues, do të trajtohet si organizatë individuale.



## **Ngritja e procedurës për pranim në anëtarësi**

### **Neni 16**

1. Organizata e interesuar dorëzon letër me kërkesë për pranim, me të cilën i bashkëngjitë:
  - Deklaratën me shkrim për formën e kërkuar të anëtarësimit (e plotfuqishme ose shoqëruese;
  - Dokumentacion me shkrim me të cilin i vërteton kushtet e lartpërmendura (për shembull, statuti, plani strategjik, raportet vjetore, arkivi medial etj.);
  - Deklaratë me shkrim për pranimin e vlerave dhe rregullave për punë të platformës.
2. Organizatat të cilat janë të inkuadruara në procesin e krijimit të platformës, anëtarësisë së vet e realizojnë përmes dorëzimit të deklaratës me shkrim për pranimin e vlerave dhe rregullave për punët të platformës.
3. Dokumentacioni i plotë duhet të nënshkruhet dhe të vërtetohet nga ana e përfaqësuesit të autorizuar të organizatës.
4. Dokumentacioni i plotë dorëzohet deri te Sekretariati i platformës.

## **Procedura për miratimin e vendimit për anëtarësim**

### **Neni 17**

1. Sekretariati e verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga organizata e interesuar lidhur me kriteret për anëtarësim.
2. Në procesin e verifikimit të dokumentacionit, Sekretariati mund ta konsultojë Këshillin drejtues, si dhe të kërkojë dokumentacion shtesë nga organizata e interesuar për punën e organizatës.
3. Sekretariati e dorëzon dokumentacionin përmendim deri te Këshilli drejtues.
4. Këshilli drejtues jep propozim për vendim për pranim pasi ta vërtetojë Kuvendi i platformës.
5. Vërtetimin e vendimit e kryen në mbledhjen e parë të ardhshme të Kuvendit ose përmes e-mail listës (nëse Kuvendi nuk mund të mbledhet).
6. Vendimin për pranim e sjell me shumicë të thjeshtë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Kuvendit (50% + 1).

### **Afatet për miratimin e vendimit për anëtarësim**

#### **Neni 18**

1. Propozim vendimin për pranim të anëtarit Këshilli drejtues e miraton në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të dokumentacionit.
2. Vërtetimin e vendimit për pranim Kuvendi e miraton në mbledhjen e parë të ardhshme me propozim të vendimit të Këshillit drejtues.

### **Arsyetimi i vendimit**

#### **Neni 19**

1. Vendimin për pranim të anëtarit duhet të arsyetohet dhe të miratohet në formë të shkruar deri te organizatat e cila ka aplikuar për anëtarësim.

## **V. KUSHTET DHE PROCEDURA PËR PËRJASHTIM TË ANËTARËVE NGA PLATFORMA**

### **Shkaqet për përjashtim nga platforma**

#### **Neni 20**

1. Anëtarët e platformës mund të përjashtohen nga platforma nëse ekziston së paku një ose më shumë shkaqe nga këto që vijojnë:
  - Anëtarja vetë ka kërkuar të dale nga anëtarësia;
  - Veprim publik në kundërshtim me parimet e platformës;
  - Aktivitet i kundërt me parimet e platformës dhe aktet tjera të platformës, vendimet e Kuvendit ose vendimet e Këshillit drejtues;
  - Moskryerja e obligimeve në zbatimin e projekteve të përbashkëta të platformës;
  - Mungesë në së paku tre mbledhje të Kuvendit, e gjatë kësaj nuk ka deleguar zëvendës.
  - Çrregullimi i vazhdueshëm i marrëdhënieve në suaza të platformës;
  - Dëmtimi i imazhit të platformës ose ndonjëris nga anëtarët dhe
  - Keqpërdorimi i platformës për interesa personale në pajtim me rregulloren.

## Procedura për përjashtim nga anëtarësimi

### Neni 21

1. Procedurë për përjashtim nga anëtarësimi mund të iniciojë çdo anëtare e platformës, me propozim të argumentuar, i cili dorëzohet deri te Këshilli drejtues.
2. Pas pranimit të propozimit, Këshilli drejtues e shqyrton dhe nëse vërteton se është i argumentuar, dorëzon letër deri te organizata për të cilën kërkohet përjashtimi dhe prej saj kërkohet të deklarohej.
3. Afati për t'u deklaruar për organizatën është 15 ditë. Nëse organizata nuk deklarohej në afatin e caktuar, Këshilli drejtues mund të ndërmarre hapa vijuese;
4. Pas pranimit të sqarimit, Këshilli drejtues i shqyrton dhe i vlerëson gjetjet në sqarim, dhe konsultohet me të gjitha shoqatat – anëtare të platformës nëse ka nevojë.
5. Nëse në bazë të fakteve të vërtetuara përfundohet se ekzistojnë shkaqe për përjashtim, Këshilli drejtues e vërteton propozimin për përjashtim.
6. Propozimin e arsyetuar për përjashtim Këshilli drejtues e dorëzon deri te Kuvendi.

## Vendimi për përjashtim

### Neni 22

1. Vendimin për përjashtim e miraton Kuvendi.
2. Për miratimin e vendimit nga alineja 1 e këtij neni nevojitet shumicë e votave nga numri i përgjithshëm i votave të anëtarëve të Kuvendit (50% + 1).
3. Vendimi për përjashtim duhet të arsyetohet.
4. Vendimi për përjashtim është përfundimtar dhe hynë menjëherë në fuqi.
5. Vendimi i Kuvendit dorëzohet derti te anëtarja e Platformës për përjashtimin e të cilës është miratuar vendimi dhe publikohet në ueb faqen e platformës.

## VI. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

### Neni 23

1. (Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen në mënyrë dhe procedurë të cilat janë paraparë me miratimin e saj.
2. Rregullorja hyn në fuqi me ditën e miratimit.
3. Rregullorja publikohet në ueb faqen e platformës.